



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 23 korrik 2020, në mbledhjen e XXVI-të (njëzet e gjashtë) e jashtëzakonshme, mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

E thirrur me kërkesë të 13 këshilltarëve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhes, dhe filloi në orën 10;10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Fatlume Jaha, Vendenis Lahu, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, Endritë Murati, dhe Patriot Rudari.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Vezir Januzi, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR, Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, Agim Blakçori, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA.

Rendi i ditës

➤ **Dëmet e shkaktuara në kulturat bujqësore nga vërshimet dhe breshëri**

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje, ndër të tjera shtoi, jeni në dijeni se ky takim, por edhe seanca e nesërme është thirrur me kërkesë të 13 këshilltarëve të Kuvendit të Komunës duke përcaktuar edhe pikën e rendit të ditës, andaj meqë është thirr kjo mbledhje do të dëshiroja të diskutohej rreth kësaj teme në mënyrë që për nesër të paktën anëtarët e KPF t'i kenë të sqaruara disa prej çështjeve që mund të ngritën, fjala është që debati të zhvillohet në kuptimin pozitiv të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore por nëse ka raste edhe në lëmi të tjera. Prezent kemi drejtorët e dy Drejtorive përkatëse të cilët sigurisht që janë të gatshëm të na japin sqarime dhe informata rreth dëmeve të shkaktuara, veprimeve që janë ndërmarrë nga Drejtoritë përkatëse.

Këtë mbledhje e kemi të jashtëzakonshme dhe me vetëm një pikë të rendit të ditës, por megjithatë kërkoj të deklaroheni se a jeni që të vazhdohet me këtë mbledhje.

Njëzëri u pajtuan që të vazhdohet me këtë mbledhje sipas thirrjes

Kryesuesi i Kuvendit, me pajtimin e anëtarëve të KPF-së, fillimisht fton drejtorët e dy Drejtorive përkatëse që paraprakisht të japin informata dhe sqarime tjera varësisht fushveprimtarisë së tyre.

z.Vezir Januzi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR, theksoi, për fat të keq pothuajse gjatë gjithë këtij viti fermerët llapjan kanë pësuar dëme të jashtëzakonshme nga kushtet klimatike, për çka edhe ne si Komunë jemi të shqetësuar, duke filluar nga muaji janar ku ka pas shumë ngrica në kultura të ndryshme bujqësore, mandej është shfaqur pandemia ku shumica e fermerëve të kulturave bujqësore siç janë karrota, lakra dhe sallata e gjelbër për të cilat ka qenë koha që ato të dalin në treg, nuk kanë mundur të dalin në treg këto prodhime dhe pothuajse fermerët llapjan shumicën e këtyre prodhimeve i kanë hedhur në mbeturina, ndoshta me qindra ton lakër dhe karrot, gjë e cila është shqetësuese qoftë për ne si Ekzekutiv i Komunës qoftë për ju si Kuvend i Komunës.

Territori i Komunës së Podujevës pothuajse ka qenë 4 herë i atakuar nga vërshimet dhe breshëri, dhe gjatë gjithë kohën Komisioni i Komunës i cili është i përbërë nga zyrtar të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, si dhe të DBPZHR kanë qenë në terren dhe kanë takuar pothuajse gjithë fermerët e prekur nga këto kushte klimatike ku pastaj janë bërë raporte përmbledhëse të cilat i kemi dërguar në institucionet gjegjëse siç është Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural duke kërkuar që këto dëme të kompensohen, pasi që jemi në dijeni se qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë një buxhet për këto kategori të prekura, ku si Komunë përkatësisht nga Nënkryetari i Komunës janë dërguar 4 shkresa apo raporte vlerësuese dhe vetëm një deri më sot është kthyer pozitivisht, konkretisht raporti i dytë (31.03.2020 – 29.05.2020) raport sipas të cilit ka qenë një shumë prej 17,333.00€ si vlerësim i dëmeve në përgjithësi për këtë kohë dhe që është kërkuar që 25% e këtyre dëmeve të kompensohen.

Kërkesat tjera janë në procedurë dhe jemi duke pritur, dhe nga biseda me Ministrin e Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kemi shumë besim se këto dëme do të kompensohen.

Dëshiroj që shkurtimisht t'ju paraqes në pika të shkurtra edhe shifrat e vlerësimeve të dëmeve, dhe atë; Nga data 01.01.2020 deri më datën 31.03.2020 kemi dëme të cilat janë vlerësuar në shumë totale prej 21,415.00€, pastaj nga data 31.03.2020 deri më 29.05.2020 kemi dëme në kultura bujqësore në shumë prej 17,333.00€, nga data 29.05.2020 deri më 01.07.2020 janë vlerësuar dëme në shumë prej 98,443.00€, mirëpo për fat të keq që ishte edhe pandemia gjatë kësaj kohe një numër i fermerëve nuk kanë pasë qasje dhe nuk kanë mundur që brenda asaj kohe të shkurtër prej 5 ditëve që është t'i paraqesin dëmet e pësura e që pastaj kemi bërë edhe një aneks raport shtesë për disa fermerë shumë të vyeshëm në kulturën e boronicës të cilët vërtetë kanë qenë të prekur nga kushtet klimatike (njëri në fshatin Shajkoc kurse tjetri në fshatin Dyz), kështu që kemi bërë edhe një raport shtesë vlerësues të dëmeve për periudhën kohore 01.01.2020 deri më 01.07.2020 ku vlera e dëmit ka rezultuar në shumë prej 179,270.00€. Komplet dëmet në bujqësi për periudhën janar – qershor 2020 në Komunën e Podujevës, në bazë të vlerësimeve të Komisionit arrijnë vlerën 316,461.00€.

Nënkryetari i Komunës por edhe ne të tjerët përmes rrjeteve sociale dhe përmes televizioneve i kemi informuar të gjithë fermerët dhe bujqit, edhe pse personalisht kam qenë në terren dhe i kam vizituar dhe vërtetë është shqetësuese për dëmet e shkaktuara, sidomos në fshatrat Konushec, Penuhë, Siboc, Sfeçël, Dumosh, Shajkoc dhe Herticë, ku breshëri i rënë më datë 18.07.2020, ka edhe dëme të konsiderueshme ku deri më sot kemi një numër prej 50 fermerëve të cilët kanë paraqitur kërkesën për verifikimin dhe vlerësimin e këtyre dëmeve.

Besoj që këtyre fermerëve duhet t'iu dilet në ndihmë sepse në njërin anë pandemia dhe në anën tjetër kushtet klimatike kanë bërë që dëmet vërtetë të jenë shqetësuese.

Pra kjo ishte vetëm sa për fillim kurse në vazhdim shpresoj se çdo shqetësim, vërejtje apo sugjerim do ta zgjidhim bashkërisht në mënyrë që fermerët llapjan të mos zhgënjehen por të vazhdojnë me kultivimin e prodhimeve të ndryshe bujqësore.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, theksoi, problematika në fjalë shpesh herë ndërlidhet edhe me infrastrukturën qoftë të lumenjve, qoftë të urave qoftë të segmenteve të tjera, por megjithatë gjatë vërshimeve që ishin posaçërisht në muajt maj-qershor, ka qenë një ekip e përbërë prej dy Drejtorive që ka intervenuar në shumë raste në terren, sigurisht aty kanë mundur të intervenojnë sepse në momentet kur ka ujë të madh në disa raste edhe nuk mund të intervenohet ku shembull, në lumin Dumnica vëllimi i ujit ka qenë diku 10 herë më shumë se kapaciteti i shtratit, do të thotë ka qenë e papërballueshëm, pastaj një pjesë edhe në fshatin Sfeçël pavarësisht hapjeve. Pastaj në fshatin Pakashticë ka pas probleme në disa ura apo kalesa që janë në atë fshat ku terreni është bukur i rëndë e që është dashtë të shkohet dhe të bëhej de bllokimi i atyre kalesave, terren në të cilin kemi vlerësuar që vitin e ardhshëm duhet t'i ndërtojmë të paktën 2 ura më të mëdha në vend të atyre kalesave që lidhen me rrugën kryesore sepse ndoshta me ardhjen e mbeturinave të ndryshme nga ato viset më të larta ku atë natë ka qenë rrezik që të ketë përmbytje edhe brenda shtëpive në rast të mos intervenohej deri në orët e vona.

Në fshatin Dumnicë ka qenë një segment në lagjen Uka, afërsisht 70-80 metra ku ishte një shtëpi afër një prrocke ku është dashtë të intervenohet me nxitim e që për fat të mirë është bërë hapja.

Probleme më të rënduara kanë qenë në fshatin Siboc – Lagja Rrahmani si dhe një pjesë të fshatit Llugë, segment për të cilin vlen të ceket se ne si Komunë 4-5 herë kemi dashtë ta zgjerojmë shtratin e atij lumi por që nuk kanë lejuar disa prej banorëve aty sepse kanë probleme të theksuara pronësore dhe të tjera në atë pjesë, por që në këtë vit mendojmë se është e domosdoshme ta bëjmë hapjen apo zgjerimin e atij segmenti të shtratit të lumit. Është për tu theksuar se në këtë vit aty ku është intervenuar me zgjerim të shtratit të lumenjve, pengesat kanë qenë më minimale për të mos thënë fare, mirëpo kemi edhe raste tjera që nuk lejojnë banorët të punohet siç është një pjesë e fshatit Bellopojë ku 2 ditë kanë qëndruar ekskavatorët aty por që disa banorë nuk kanë lejuar të bëhet zgjerimi i shtratit ku vazhdimisht paraqiten pengesa. Rreth kësaj mund të them se problematika e zgjerimit të shtretërve të lumenjve është paksa e ndërlikuar sepse me kohë ndoshta nuk është caktuar baza e shtratit qoftë në lumin Llap qoftë në lumenj dhe procka të ndryshme e që po të shkohet tani me gjeodet dhe kadastër ndoshta ndokund i bie të rrënohen edhe shtëpi banimi. Për shkak të mos mirëkuptimit mes banorëve është e pamundur të rregullohen çështje të tilla sepse ka lëvizje të mëdha, madje ndoshta me 50-60 metra nga shtrati.

Në lumin Dumnicë, me përjashtim të një segmenti tek lagja Vokri në gjatësi rreth 200 metra që ka mbet pa u zgjeruar. Në fshatin Siboc, përveç zgjerimit të lumit nga lagja Rrahmani deri në fshatin Llugë, problematike është edhe një urë e cila është e ulët dhe stabiliteti i saj po paraqet problem por që ne me procedurë urgjente kemi hartuar projektin dhe tani është në procedurë të prokurimit që ajo urë të hiqet dhe të ndërtohet e re dhe më e lartë e që të paktën 40% të ujit ta përballojnë. Pra në Pakashticë kemi të paktën 2 ura që do t'i ndërtojmë, në fshatin Bellopojë kemi 2-3 problematika të kësaj natyre, konkretisht zgjerimi i shtratit të lumit e që disa banorë po e pengojnë, kemi rreth 115 metra për ndërtimin e një muri mbrojtës i cili pothuajse mbi 80% i largon problemet e që shpresojmë se do të lejojnë edhe banorët aty afër sepse tani veç e kanë vërejtur gjithë atë dëm që iu është shkaktuar nga vërshimet, si dhe problemi i kanalizimit atmosferik në rrugën kryesore ku disa shtëpi janë ulët dhe që e kanë mbyllur kanalin atmosferik, mirëpo këtë vit do ta ndërtojmë edhe trotuarin aty dhe sigurisht që pastaj uji nuk do të mund të kaloj në ato shtëpi.

Gjithashtu në infrastrukturë është intervenuar në disa penda që janë në ndërtim e sipër, ka pas grumbullim të mbeturinave siç edhe keni mund ta shihni lumin Llap e që për fat të keq ka sjellë uji mbeturina të ndryshe përfshirë edhe mobilje të vjetruara etj, kështu që pavarësisht se dita ditës po kyçen shumë e më shumë familje në rrjetin e menaxhimit të mbeturinave megjithatë ka edhe persona të atillë që hedhin mbeturina të ndryshme në lumin Llap duke përfshirë edhe grumbullimet e ushqimeve të kafshëve që kanë qenë në afërsi të lumenjve por që i ka marrë uji por që është dashtë pastaj të

intervenohet për hapjen e tyre. Gjitha urat pothuajse kanë pasur stabilitet, pra janë kontrolluar të gjitha sepse në këto raste si problem i parë paraqiten urat sepse mund të lëvizin nga gryerja por që për fat të mirë të gjitha janë stabile, shembull në fshatin Lupç ku sasia më e madhe e ujit mbledhet atje në lumin Llap, këtë vit ka qenë rreth 1 metër nën nivelim maksimal, sidomos te lagja Humolli ku gjithëherë ka pas vërshime dhe probleme këtë vit nuk kemi pas probleme sepse duke i falënderuar edhe banorët që kanë lejuar të ndërtohet muri mbrojtës nuk ka pas telashe, pra ka pas një qasje pozitive nga vetë banorët në atë pjesë. Pra kjo dukuri është jashtëzakonisht e rëndë dhe do të kërkoja edhe nga secili prej juve që të na ndihmoni aty ku keni mundësi sepse vërtetë në disa raste jemi në dilemë ngase janë probleme që në fillim duken të vogla por që kur dalim në terren paraqiten më shumë se që mendohet, përmenden probleme 50 vjeçare mes banorëve dhe familjeve rreth parcelave etj etj, vërtetë janë çështje problematike dhe po të jeni aty prezent do të çuditëni se çfarë problemesh ka, kurse pastaj kur po atyre ju ndodhin probleme të tilla me vërshime dalin në opinion dhe akuzojnë komunën, shtetin, qeverinë e ku ta dijë unë, por që në fakt nuk ekzistojnë fare ato sepse janë banorë tanë dhe vazhdimisht po mundohemi t'i tejkalojmë ato probleme.

Gjatë kësaj periudhe të vërshimeve kemi pas tri kërkesa për riparime të rrugëve me zhavorr, në fshatin Shajkoc një lagje që janë dy familje që jetojnë e që dy herë e kemi shtruar me zhavorr por ka një grua të sëmurë në njërin prej familjeve dhe është dashur që në procedurë emergjente të riparohet, pastaj në fshatin Turuçicë është kërkuar të ndërhyhet por meqë është e asfaltuar ajo rrugë nuk kemi ndërhyrë si dhe në fshatin Gërdoc në një lagje e cila e cila ka qenë e riparuar por që ka pësuar dëme mirëpo meqë nuk kishte banorë ende nuk e kemi riparuar.

Këto janë disa prej problematikave nga dëmet e shkaktuara, por unë më shumë desha që ju të ambientoheni me këtë dukuri ku një pjesë të tyre edhe i ceka. Është mirë që lumi Llap po e përballon këtë vëllim të ujit edhe pse kësaj radhe vëllimi i ujit ka qenë jashtëzakonisht i madh.

Kemi pas edhe një problem në rrugën Bellopojë – Ballaban ku ka pas shembje dhe është mbyllë pothuajse gjysma e rrugës e që është dashtë të intervenojmë me nguti. Po shpresojmë që me këto ura, zgjerime, intervenime tjera me mure mbrojtëse që kemi këtë vit do të zgjidhet kjo çështje dhe do të zvogëlohen dëmet nga vërshimet por që ato asnjëherë nuk do tejkalohen të gjitha.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, kemi vetëm një pikë të rendit të ditës dhe kuptohet se i rekomandojmë Kuvendit për seancën e radhës. Sa i përket raportimit të dy drejtorëve të Drejtorive përkatëse më erdhi mirë që Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka ndërmarrë hapat konkret për shqyrtimin e situatës dhe ishte një praktikë e mirë që fillimisht iu dha fjala drejtorëve në mënyrë që të mos themi gjithçka politike dhe të mos flasim diçka çka nuk është ashtu pastaj ne në Kuvend, por të njoftohemi me situatën e krijuar, dhe është mirë që ne si këshilltarë dhe si Kuvend ta vlerësojmë situatën ashtu siç është, kur është mirë ta vlerësojmë mirë, kur është keq ta vlerësojmë keq, pavarësisht perceptimeve politike. Të gjithë jemi në dijeni se Komuna e Podujevës në këtë vit është më e rënduar qoftë me buxhet qoftë në aspekte tjera për shkak të situatës së pandemisë në drejtim të hapave të ndarjes së buxhetit dhe funksionimit të bizneseve e që do të jetë paksa më e vështirë për kompensime edhe nëse kemi dëshirë përmes Drejtorisë përkatëse mirëpo sa dëgjova raportimin e drejtorit të DBPZHR shpresojmë në kompensimin e dëmeve nga ana e Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për çka e motivojmë drejtorin dhe jemi të gatshëm që përmes kanaleve tona qoftë politike qoftë shoqërore të mundohemi të kemi ndikim që sa do që mundemi të tërheqim një buxhet për kompensimin e dëmeve për fermerët dhe të prekurit tjerë nga vërshimet dhe kushtet tjera atmosferike në Komunën e Podujevës.

Gjithashtu edhe drejtori i DSHPMSh na informoj rreth gjendjes infrastrukture, jemi në dijeni se gjendja është paksa më e rënduar për shkak të buxhetit të limituar që ka kjo Drejtoria, është obligim që ne si qytetarë t'i ruajmë ambientet dhe hapësirat përreth lumenjve dhe të mos hudhen mbeturina në lumenj, gjë të cilën po e them në bazë të asaj që kam parë gjatë kohës së vërshimeve.

E kemi parasysh se gjërat atmosferike janë të paparashikuara dhe nuk varen nga njeriu por ne duhet të ballafaqohemi aq sa mundemi sepse kemi të bëjmë me natyrën dhe nuk mund të bëjmë atë që kemi dëshirë kjo është e kuptueshme, mirëpo meqë është bërë skanimi i situatës për DSHPMSh do të jetë më e lehtë për të intervenuar me planifikime buxhetore në vitin e ardhshëm.

Edhe pse kjo seancë është thirr, sa i përket DBPZHR nuk kam diçka rreth këtij raportimi për arsye se as Kuvendi nuk ka qenë i informuar për këtë situatë dhe këto veprime të ndërmarra, mirëpo besoj që nesër në mbledhjen e Kuvendit ne do të diskutojmë sërish dhe do t'i harmonizojmë mendimet dhe qëndrimet tona rreth stabilizimit të gjendjes së fermerëve që sipas vlerësimeve dëmet e shkaktuara janë vlerësuar mbi 300,000.00€. Dashtë Zoti që mos të kemi më kushte klimatike të tilla.

z.Vendenis Lahu, theksoi, lidhur me këtë mbledhje dhe këtë temë besoj që do të ishte mirë që nesër në Kuvend nga Drejtoria përkatëse të sjellët një raport i dëmeve në terren që ka arritur të konstatojë Drejtoria përkatëse, në mënyrë që të shohim se cila është gjendja reale dhe cilat janë dëmet e shkaktuara në mënyrë që të shikojmë mundësitë e kompensimit nga vet ne si Komunë sepse të gjitha ato që fermerët kanë planifikuar të marrin nga të mbjellat ndoshta të gjitha kanë shkuar në dëm, kështu që mendoj se është mirë dhe duhet t'i mbështesim.

Problematikë e këtyre vërshimeve të ditëve të fundit ka qenë edhe përmbytja e disa rrugëve në qytet, për çka mendoj se është paksa e çuditshme se çdo herë ku po ka reshje paksa më të mëdha por edhe në sasi më të vogla neve po na përmbysen rrugët andaj e cekta se është paksa e çuditshme që pothuajse për çdo vit intervenohet nëpër rrugë të qytetit dhe sërish po ka përmbytje e që besoj se edhe kjo është një prej problematikave lidhur me çështjen e reshjeve dhe vërshimeve që pothuajse ndodhin për çdo vit, disa ndoshta për shkak të mos intervenimit të mjaftueshëm të Komunës, por për disa e kemi parasysh se edhe me intervenim ndoshta nuk mund t'i ndalë për shkak të rrethanave dhe kushteve të ndryshme.

Pra unë do të dëshiroja që nesër në seancën e Kuvendit të kemi një raport nga drejtori i DBPZHR dhe pastaj të shohim.

z.Vezir Januzi, drejtor i DBPZHR, theksoi, unë e potencova një shifër të dëmeve të vlerësuar që ishte rreth 316,000.00€ nga janari deri në fillim të korrikut, mirëpo dëmet më të mëdha janë nga breshëri i cili ka përfshirë disa pjesë të territorit të Komunës së Podujevës më datë 18 qershor 2020, dhe deri më tani kemi edhe rreth 50 kërkesa të fermerëve që janë drejtuar Komunës dhe me këtë dëm shuma e dëmeve do të rritet shumë, ndoshta me 500 - 600,000.00€. kështu që qoftë me kërkesat tona por edhe seanca që është thirr besoj se do të ndikoj shumë pozitivisht dhe shumë më mirë tek institucionet qendrore që vërtetë këtyre fermerëve t'iu dilet në ndihmë.

z.Patriot Rudari, theksoi, muaji qershor ka qenë muaji më i lagësht i vitit që 16 vite e këndeje, pra kjo është sipas Institutit hidrometeorologjik, rreth 182mm për m² reshje shiu, dhe ka sjellë pasojë.

Jemi me fat që liqeni i Batllavës nuk ka qenë i mbushur në nivel sepse përndryshe do të kishte pasojë shumë të mëdha, me theks deri në fshatin Lupç i Poshtëm.

Sa i përket rënies së breshrit, në fshatin Shajkoc ka rënë, madje ka bërë edhe dëme në një familje (Avdush Durmishi) ku uji ka depërtuar brenda, pastaj në bujqësi ka bërë dëme të konsiderueshëm sikurse në fshatrat tjera e që vlen të përmendet se fermerin Lorik Durmishi e ka dëmtuar shumë në kulturat bujqësore që ai i kultivon (pjepën, boston) të cilat pothuajse i ka prishur në total dhe i cili nuk ka të ardhura tjera përveç nga bujqësia, andaj është mirë të ndihmohen këto dy raste.

z.Mehmet Gashi, theksoi, i përgëzoi drejtorët e dy Drejtorive të cilët na informuan në detaje rreth masave të ndërmarra nga Ekzekutivi i Komunës për pasojat nga vërshimet dhe breshëri. Mendoj se ne si Kuvend i Komunës çdo kërkesë të qytetarëve duhet ta përkrahim, mirëpo ashtu siç na informoj edhe drejtori jam në dijeni se raportet vlerësuese bëhen nga një Komision i cili del në terren dhe verifikon, vlerëson dhe harton raport për dëmet e secilit fermer dhe ekonomi familjare.

Kërkesat për kompensim të dëmeve paraqiten në Komunë nga fermerët dhe familjarët e prekur nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, por identifikohen edhe nga vetë Komisioni dhe shërbimet tjera të Komunës, mirëpo sa i përket kompensimit të dëmeve buxheti për një gjë të tillë është në fushën e kompetencave të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kështu që ne si Kuvend çdo kërkesë do ta mbështesim.

Edhe te Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, drejtori na informoj rreth pasojave dhe intervenimeve të bëra nga kjo Drejtori por edhe nevojave për buxhet në këtë vit ku me ridestininim të mjeteve mund të mbështeten por edhe në projektet e vitit të ardhshëm besoj se si Kuvend i Komunës do t'i përkrahim të gjitha planifikimet buxhetore dhe projektet përkatëse sepse është në interes të qytetarëve marrja e masave për t'iu dal në ndihmë qytetarëve.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, po vërehet se Komuna e Podujevës vërtetë gjatë këtij viti është dëmtuar bukur shumë nga vërshimet, breshëri dhe fatkeqësi tjera natyrore ku sipas asaj që u informuam deri më tani janë rreth 316,000.00€ dëme të vlerësuara pa përfshirë edhe 50 fermer të cilët kanë presuar dëme tash së fundmi ku sipas asaj që u potencua pitet që kësaj shume t'i shtohen edhe rreth 60,000.00€, e që në këtë kohë krize ekonomike nga pandemia vërtetë është dëm i madh për ekonominë por më së shumti për vetë ata fermer të cilët të vetmin burim e kanë nga bujqësia. Sipas mendimit tim po del se ka qenë shumë i qëlluar investimi i bërë viteve të fundit për pastrimin dhe zgjerimin e lumenjve dhe proçkave tjera për arsye se duke u bazuar nga përvoja që kam në këtë Drejtori dhe që jam përballë shumë me këto çështje ku vetëm nëse e marrim me mend përballimin me një situatë të tillë në fshatin Lupç i Poshtëm ku grumbullohen të gjitha lumenjtë dhe proçkat e Llapit.

Pra nga këto investime konsideroj se janë evituar shumë më shumë dëme të cilat mund të kishin ndodhur qoftë në bujqësi qoftë në infrastrukturë sepse siç dihet tokat më pjellore dhe që punohen janë në afërsi të lumenjve, por ndoshta fat i mirë është se ka pas edhe një thatësi të madhe të tokës dhe kjo mund të themi se ka mund të ndikoj në baraspeshë sepse përndryshe dëmet do të ishin shumë më të theksuara.

Pra të mbetet si konstatim i të gjithëve se në kuadër të mundësive që kemi por edhe me një angazhim dhe trysni të përbashkët të ndërmarrim të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që Ministria përkatëse të bëjë kompensimin e dëmeve për fermerët dhe ekonominë tjera familjare nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Pra ashtu siç e ceku z.Rafet Llapashtica, kushdo që kemi mundësi dhe ndikim ndokund qoftë si individ qoftë si Kuvend të mos kursehem i që sado pak t'iu dilet në ndihmë të gjithë të prekurve në mënyrë që t'i ruajmë fermerët tanë dhe të tjerët, t'i inkurajojmë dhe t'iu japim mbështetje për të vazhduar me punë në mënyrë që të mos demoralizohen në bizneset e tyre, aq më shumë edhe kur kësaj i shtohet edhe situata nga covid-19 ku një pjesë e fermerëve në muajt e kaluar kanë pritur që t'i shesin produktet e tyre por që për shkak të mbylljes së shumë bizneseve nuk kanë mund të plasojnë në treg.

Angazhimi duhet të jetë nga të gjithë për të gjithë në mënyrë që sa do pak të jemi sa më afër qytetarëve e që besoj se të gjithë kemi të njëjtin mendim, andaj besoj se të gjithë jeni që kjo pikë – temë t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në mbledhjen që është thirr për nesër.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit që seanca të mbahet sipas thirrjes dhe rendit të caktuar të ditës, dhe njëkohësisht Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0038510/20

Podujevë,

23 korrik 2020

Kryesuesi i Komitetit

Fatmir Gashi